



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227364
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05496904

C-IV-14-0338

Ankuesi

A A, fshati K, Viti.

Përfaqësuar nga avokat L E, Viti.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 25 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI095-0463 datë 09 janar 2014, si i drejt dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 20 janar 2014, ankuesi (nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. GJI095-0463 datë 09 janar 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 9,838.90 € për periudhën 22 shtator 1991 – 07 korrik 1999 dhe kompensim për shpenzimet gjyqësore në shumë prej 300.00 €, nga NSH “Banja e Kllokotit” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka qenë punëtor i kësaj ndërmarrje në vendin e punës mishtar në qendrën për shërim dhe rehabilitim Banja e Kllokotit dhe që nga data 22 shtator 1991 është larguar nga puna pa kurrfarë procedure ligjore por në bazë të ligjeve diskriminuese serbe dhe se për këtë ka ushtruar ankesë por më është refuzuar ankesa dhe se pastaj ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Viti, mirëpo dokumentacioni i tillë nuk gjendet tani në gjykatë. Ankuesi më tej theksoi se një pjesë e dokumentacionit gjenden në lëndë tek e paditura dhe se sipas rrethanave të

luftës një pjesë e dokumentacionit nuk ekziston as tek ai as në gjykatë. Ankuesi pohoi se numri i lëndës – padisë që ka ekzistuar në Gjykatën Komunale në Viti është PL.br.90/92 që dëshmon se ankesa është dorëzuar me kohë brenda periudhës së përcaktuar me ligj siç kërkon AL dhe se për këtë çështje ka parashtruar përsëri padi pranë Gjykatës Komunale në Viti me nr. të lëndës C.nr.153/06. Kjo gjykatë e ka pruar aktgjykimin dhe ka aprovuar kërkesën e tij. Ankuesi më tej theksoi se sipas këtyre dokumenteve valide shihet se ka punuar në këtë NSH dhe se është larguar nga puna në bazë të Ligjit diskriminues serb Ligji mbi punën në rrethana të jashtëzakonshme (GZ RSS nr.40/90 dhe nr. 54/90 dhe 45/91 ku e paditura e ka zbatuar me qëllime politike për të larguar sa më shumë punëtorë shqiptarë nga puna, për të argumentuar se ligji serb ka qenë diskriminues ku edhe ai është larguar nga puna vetëm se ka përdorur gjuhën shqipe pra shihet sipas vendimit diskriminues të organit të përkohshëm nr.768 datë 16 gusht 1991 ku vetëm gjuha serbe lejohet të aplikohet në ndërmarrje. Ankuesi më tej thekson se menjëherë pas luftës ku punëtorët janë kthyer në punë viti 1999 të gjitha këto vendime janë lënë jashtë fuqie dhe se ai i plotëson të gjitha kushtet ligjore që kanë të bëjnë me kompensimin e të ardhurave personale, shpenzimet gjyqësore për periudhën e largimit nga puna deri në ditën e kthimit në punë dhe se për këtë duhet vënë në zbatim edhe Ligjin e Kosovës kundër diskriminimit nr. 2004/3 i vitit 2004 i pruar nga Kuvendi i Kosovës e i nënshkruar dhe aprovuar nga përfaqësuesi special i Kombeve të Bashkuara – UNMIK me urdhëresë nr. 2004/32 dhe në bazë të këtij ligji Dhoma e Posaçme ka pranuar disa aktgjykime SCEL-06016 ku edhe tek ai do të vjen në shprehje zbatimi i këtij ligji pasi që kemi të bëjmë me largim nga puna në bazë të diskriminimit e nga organi i dhunshëm serb i instaluar në NSH-në ku ka punuar. Ankuesi i propozon gjykatës që duke u bazuar në Ligjin nr.04/L-034, neni 37.8 të vendos në favor të tij duke i pasur parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë dhe që e paditura të ia kompensoj shumën e kërkuar. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: Padinë e ushtruar në Gjykatën Komunale në Viti nr. PL.nr.90/92, (data e palexueshme), Vendimin për hedhjen e padisë lëshuar nga Gjykata Komunale në Viti nr. 90/92 datë 10 korrik 1992, Kundërshtimin nr. 3, datë 13 janar 1992, Aktgjykimin e Gjykatës Komunalë në Viti C.nr.153/06 datë 03 nëntor 2006, Procesin – Ekspertizën financiare datë 04 tetor 2006, Vendimin për refuzimin e kundërshtimit lëshuar kryetari i organit të përkohshëm të NPSH “Banja e Klllokotit” datë 10 tetor 1991, Njoftimin në lidhje me kontestin gjyqësor drejtuar AKM-së nga NSH “Banja e Klllokotit” nr. 214 datë 28 gusht 2006, Autorizimin për përfaqësim (të noterizuar), Kërkesën drejtuar gjykatës për lirim nga përkthimi i dokumentacionit në gjuhën angleze datë 17 janar 2014, Fletë lëshimin me nr. amze 1982 lëshuar nga QKUK Prishtinë,

Me 3 gusht 2015, përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi parashtrësën përmes së cilës e njofton gjykatën se padia sipas lëndës C.nr. 90/92, ishte dorëzuar me kohë në gjykatë dhe se dokumentacioni i tillë pas luftës është asgjësuar apo zhdukur dhe këtë e vërteton me njoftimin e vet edhe Gjykata Komunale. Në mbështetje të kësaj parashtrëse përfaqësuesi i ankuesit dorëzoi Informatën nr. GJA 71/2015, datë 31 korrik 2015, lëshuar nga Gjykata Themelore Gjilan – Dega Viti, përmes së cilës njoftohet nga gjykata se shumica e lëndëve të të gjitha natyrave të paraluftës nuk gjinden në arkivin e gjykatës dhe se për lëndët që mungojnë nuk dihet asgjë se kur dhe kush se si janë humbur apo zhdukur.

Me 30 shtator 2015, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura thekson që të gjithë “dëshmitë mbështetëse” të parashtruara nga ankuesi janë thjeshtë fotokopje të cilat nuk mbajnë vulat e duhura. Ky konstatim zbatohet edhe për padinë e cila pretendohet të jetë parashtruar nga ankuesi në vitin 1992 kundër NSH-së. Kërkesa e tillë është thjeshtë një fotokopje me një numër të shkruar me dorë në krye të saj. Nuk ka asnjë vulë e cila do të vërtetonte që kërkesa është pranuar ndonjëherë në shkrimoren e gjykatës komunale. E paditura më tej pohon se e njëjta gjë vlen edhe për Aktgjykimin C.nr.154/06 pasi që aktgjykimi i tillë nuk përmban vulën e plotfuqishmërisë e cila konfirmon që aktgjykimi më pas nuk është shfuqizuar. E paditura më tej thekson se në arsyetimet e mësipërme dhe në mungesë të provave për të dëshmuar të kundërtën, ankuesi nuk ka ndërprerë afatin e zbatueshëm të parashkrimit, prandaj pretendimet e tij ndaj NSH-së janë të parashkruara. E paditura më tej thekson se vendimi i mësipërm është në përputhje me jurisprudencën e Dhomës së Posaçme e cila ka njohur këtë arsyetim dhe e ka zbatuar në disa raste të ngjashme (*shih ex multis* Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme C-IV-13-0889 datë 25 mars 2014, SCL-11-0046 dhe C-II-13-0190 të dyja datë 14 janar 2014 etj). Ankuesi nuk ka ofruar asnjë dëshmi të besueshme e cila vërteton që vendimi i NSH-së për shkarkimin e tij në vitin 1991 është rrëzuar, anuluar ose shfuqizuar në ndonjë mënyrë tjetër dhe se ai nuk ka ofruar asnjë dëshmi të besueshme për të vërtetuar që NSH i detyrohet atij ndonjë sasi të hollash. Rrjedhimisht, dokumentet në mbështetje të kërkesës së tij ishin dhe mbetën jo të plota në kuptim të Nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 edhe pas kërkesës për informata plotësuese të dërguar nga AL. E paditura më tej thekson se sa i përket argumenteve në lidhje me diskriminimin e ankuesit argumentet e tilla nuk janë objekt i kësaj procedure gjyqësore. Objekt i kësaj procedure është vetëm kërkesa për paga e parashtruar nga ankuesi në AL dhe vendimi për këtë kërkesë. Pretendimet për kompensim mbi baza të tjera si diskriminimi nuk mund drejtpërdrejtë të parashtrohen në Dhomën e Posaçme, por së pari duhet të parashtrohen tek AL. Pa paragjykuar qëndrimin e mësipërm, nuk ka asnjë dëshmi për të vërtetuar se ankuesi ka qenë i diskriminuar. Duke pasur parasysh që ankesa është e pabazuar, mbi bazën e argumenteve si më lart, E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Kërkesën për Informacione shtesë dhe dëshmi mbështetëse drejtuar ankuesit datë 10 dhjetor 2013 si dhe Kërkesën për ndërrimin e anëtarëve të AL datë 15 shkurt 2013.

Me 10 dhjetor 2015, mbrojtja e të paditurës iu dorëzua ankuesit por asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Me 19 korrik 2018 dhe 07 shkurt 2020 përfaqësuesi i autorizuar kërkoi që të shqyrtohet lënda objekt kontesti.

Me 07 dhjetor 2023, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin përmes së cilit ndër të tjera kërkoi nga i njëjti që të sqaroj nëse aktgjykimi i përmendur nga e paditura (C.nr.152/06 datë 13 nëntor 2006), është i plotfuqishëm dhe dëshmi mbështetëse për të. Me 15 dhjetor 2023, ankuesi u përgjigj përmes një parashtrëse duke theksuar se ishte larguar nga puna nga organi i dhunshëm serb në bazë të ligjeve diskriminuese të asaj kohe dhe se për këtë ka ushtruar ankesë në gjykatë por që në gjykatë nuk ka asnjë dokumentacion pra janë asgjësuar. I njëjti më tej theksoi se sa i

përket aktgjykimit në fjalë, nuk është i plotfuqishëm dhe sikur të ishte i tillë AL do të ekzekutonte këtë sikur e ka bërë për rastet tjera. Aktgjykimi nuk është bërë i plotfuqishëm pasi procedura është ndërprerë me arsyetim se palët duhet ti drejtohen Komisionit të Likuidimit gjë të cilën e ka bërë pala paditëse. Në mbështetje të përgjigjes së tij ankuesi ri-dorëzoi në kopje Informatën nr. GJA 71/2015, datë 31 korrik 2015, lëshuar nga Gjykata Themelore Gjilan – Dega Viti.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit, që si e tillë është çështje e rregulluar me dispozita ligjore dhe meqenëse gjykata konstaton se është parashkruar e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore përmbushjen e detyrimit, pretendimet e tjera të palëve nuk do të shqyrtohen.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parasheh:

kërkesat që konsiderohen të jenë të pasafatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligje të aplikueshme, si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo në kohë para gjykatës kompetente, refuzohen dhe nuk gëzojnë të drejtë për të marrë pjesë në disbursimet nga likuidimi;

Gjykata gjen se neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76) në të cilin ishte mbështetur vendimi refuzues i AKP-së ishte shfuqizuar me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ 40/89) i cili ligj kishte hyrë në fuqi me 15 korrik 1989, konkretisht me nenin 74, i cili nen e plotëson Ligjin mbi Ndërmarrjet (GZ 77/88, (i cili kishte hyrë në fuqi me 01 janar 1989), konkretisht nenin 196 i cili qartësisht normon shfuqizimin e të gjitha dispozitave të Ligjit mbi Punën e Bashkuar, përveç dispozitave nga Kreu IV dhe Kreu i VI kaptina 2, dispozita e nenit 608 është e vendosur në Kreun e VI në kaptinën e 3, që do të thotë se është shfuqizuar me këtë ndryshim plotësim të ligjit. Ligji mbi Marrëdhënien e Punës i datës 14 prill 1989 dhe Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës i datës 28 shtator 1989, nuk kanë paraparë dispozita të veçanta lidhur me parashkrimin e kërkesave monetare që lindin nga marrëdhënia e punës, megjithatë kjo nuk do të thotë se instituti i parashkrimit për kërkesat monetare ka mbetur i pa mbuluar me dispozita të tjera ligjore.

Gjykata vlerëson se, për kohën kur pretendohet se është krijuar detyrimi, duhet të aplikohet parashkrimi i përgjithshëm për detyrimet civile lidhur me kërkesat periodike. Këto rregulla gjinden në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr. 690 të datës 30 mars 1978, të njëjtat rregulla gjinden edhe në Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor 2012. Në pajtim me nenin 372, paragrafi 1 i LMD-së, parashkrimi i kërkesave periodike siç është paga, është tri (3) vjet; Ligji i ri ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vitesh (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së). Po ashtu, Ligji i Punës nr. 03/L-212 i cili është në fuqi, nuk parasheh dispozitë të veçantë për parashkrimin në lidhje me pagesat e të ardhurave, por parasheh një afat të përgjithshëm prej 3 viteve të parashkrimit, në lidhje me kërkesat që lindin nga marrëdhënia e punës. Nga dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet që kanë qenë të aplikuara në atë kohë, por edhe në ligjet që tani janë në fuqi.

Prandaj, shihet se parashkrimi për kompensimin e kërkuar në këtë lëndë (për paga të papaguara në shumë prej 9,838.90 € dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 300.00 € për periudhën kohore 22 shtator 1991 – 7 korrik 1999 nga NSH “Banja e Kllokotit”) ishte i rregulluar me LMD-në (1978), i cili ishte ligj ende në fuqi në atë kohë. Vetëm në dhjetor 2012 ligji i aplikueshëm ndryshoi, por edhe LMD-ja ka mbajtur të njëjtin afat parashkrimi prej 3 vjetësh.

Me vjetërsim/parashkrim, ligjërisht shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit, parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Në rastin konkret, e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të papaguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që NSH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Sipas shkresave të lëndës dhe pohimeve të vet ankuesit, i njëjti kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 22 shtator 1991 – 07 korrik 1999, e ka parashtruar në Autoritetin e Likuidimit më 17 janar 2011, që në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, një kërkesë e tillë në atë kohë vetëm se ishte parashkruar.

Gjykata është plotësisht në dijeni për rastet e tilla dhe ka marr parasysh pretendimet e ankuesit për largimin e tij nga puna në bazë të diskriminimit (si të gjithë punëtorëve të tjerë shqiptarë, të larguar në atë kohë nga aplikimi i masave të dhunshme), por nuk ka mundur të ofroj një zgjidhje tjetër ligjore, sa i përket kompensimit të kërkuar për paga të papaguara për periudhën kohore 1991 – 1999, kjo pasi ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë nga ai moment deri në momentin e paraqitjes së kërkesës së tij në procedurë të likuidimit.

Gjykata gjithashtu nuk e mohon faktin (siç theksohet nga ankuesi) se dëshmitë e inicimit të kundërshtimeve nga punëtorët e NSH-së në gjykatën e atëhershme mund të jenë djegur apo asgjësuar gjatë luftës si dhe parashkrimit të padisë në Gjykatën Komunale në Viti sipas lëndës C.

nr. 152/06, që mund të jetë dorëzuar nga punëtorët e NSH-së, por të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe, përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar siç edhe u arsyetua më lartë. Një interpretim i tillë njëherit është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit në lidhje me raste të tilla dhe këtë NSH (AC-I-21-0281, AC-I-21-0462, AC-I-22-0651, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 30.00 € për ankesën e parashtruar dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar